



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:029427

Datë: 18.11.2021

Numri i dokumentit: 02415422

PKR.nr.50/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Shaqir Zika- kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët Drilon Haraçija dhe Myfera Hoxha- anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit K. (K.) R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/L.nr. 53/2021, të datës 17.03.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit gjyqësor me datë 11.11.2021, në prezencën e Prokurores së shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, të akuzuarit K. R. si dhe mbrojtësit të tij av. Ylli Bokshi, ndera me datën 12.11.2021, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datën 18.11.2021** përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K. R., nga i ati K., e ëma S., e gjinisë K., data e lindjes . . . , në Gjakovë, ku edhe banon në rrugën “. . .” nr. . . . , i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion punëtor, me nr. personal . . . , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Pa autorizim dhe me qellim shitje, ka poseduar substanca apo preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë në atë mënyrë që me dt.08.02.2021, gjate një pikë kontrolli nga ana e Policisë ne rr.”. . .” në Gjakovë, me të ndaluar automjetin e tipit . . . , me targa . . . , në të cilin automjet gjendej edhe i pandehuri K., i ulur ne ulësen e pasme ashtu që gjate kontrollit tek i njëjti, nën ulëse i është gjetur një letër e bardhë e mbushur me substance ne formë bari e dyshuar për narkotik të llojit Marihuanë në peshë rreth 2.90 gram, e po ashtu edhe gjatë bastisjes ne shtëpinë e tij nga ana e Njësitit të DHTN-së, ne një shupë qe gjendej ne pjesën e pasme të oborrit, nën kulmin e saj kanë gjetur një kavanoz qelqi brenda se cilës ishte e vendosur një qese najloni e mbushur me substance ku nga ekzaminimi i AKF ka treguar se është prezent Kanabisi (Marihuana) qe përmban TetrahidR.nabinol (THC), pesha neto e përgjithshme 28.4=0.0001 gram, të cilat sasi më pas janë sekuestruar nga ana e zyrtarëve Policor.

- me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg.1 te KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 6, 17, 38, 43, 46, 47, 48, 49, 71, 72, nenit 267 para 1 të KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 të KPPK-se, të akuzuarin e:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar **dënimin me burgim në kohëzgjatje prej** dy (2) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda afatit të verifikimit prej dy (2) vite, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) Euro, të cilin dënim duhet ta paguaj në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobe atëherë të akuzuarit i zëvendësohet dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, duke llogaritur për çdo dite nga njëzet (20) Euro.

Ndaj të akuzuarit konfiskohen: narkotiku dhe atë një qese plastike, me substancë marihuanë në peshë prej 2.90 gram, po ashtu tjetër qese plastike me substancë marihuanë në peshë prej 25.50 gram, pra pesha e përgjithshme është 28.4=0.0001gram.si objekt i kryerjes së veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e narkotikut të konfiskuar, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2021-EA-197.

Detyrohet i akuzuari K. R. që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.53/2021, të datës 17.03.2021, ndaj të akuzuarit K. (K.) R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me datën 28.04.2021, në të cilën seancë kanë marr pjesë Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, i akuzuari K. R. së bashku me mbrojtësin e tij av.Ylli Bokshi, nga Gjakova, sipas autorizimit në lëndë.

I akuzuari K. R., gjatë shqyrtimit fillestar është deklaruar i pafajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Pasi që aktakuza është konfirmuar gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesorë me datat 11.11.2021, ku ka prezantuar përfaqësuesi i akuzës Prokurores së shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, të akuzuarit K. R. si dhe mbrojtësit të tij av.Ylli Bokshi.

Pas zbatimit të procedurës së provave mbrojtësi i të akuzuarit av. Ylli Bokshi, ka kërkuar nga gjykata që edhe në këtë fazë ti apët mundësia të akuzuarit të deklarohet rreth fajësisë, ku përfaqësuesi i akuzës nuk e ka kundërshtuar këtë propozim.

I akuzuari K. R., ka deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin tim tani në këtë fazë të procedurës deklarohem i fajshëm për veprën penale që më vihet në barrë sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e kam bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin tim i cili mi ka shpjeguar të gjitha favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Pas deklarimit të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij gjykata kërkoi mendimin që ta jep prokurorja e shtetit e cila ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë së të pandehurit të bërë në këtë fazë të procedurës penale pasi që deklarimi i tij është i vullnetshëm, i njëjti është konsultuar me mbrojtësin e tij dhe aktakuza mbështetet në provat e siguruara gjatë procedurës së hetimeve si dhe me dëshmimin e dëshmitarëve në këtë seancë dhe administrimin e provave materiale andaj i propozoi gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. R. av. Ylli Bokshi, deklaroi se i mbrojturi imë edhe tani në këtë fazë të procedurës ti ipet mundësia që i akuzuari të deklarohet rreth pranimit të fajësisë, paraprakisht me të njëjtin jam konsultuar, dhe pas konsultimeve me të akuzuari K. R., i njëjti deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, duke i ditur pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë.

Me këtë raste gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPP-së, kështu që pas konsultimeve të mjaftueshme të të akuzuarit me mbrojtësin e tij i njëjti ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi që është kryes i kësaj vepre penale, andaj në tërësi e pranon fajësinë sipas pikës së aktakuzës dhe se ky pranim i fajësisë mbështetet në provat të cilat i janë ofruar gjykatës në aktakuzë dhe atë nga dëshmia e dëshmitarëve, A. Z. dhe D. C., si dhe nga provat materiale siç është Deklarata e të pandehurit: K. R. e dhënë në Prokurori ne praninë e mbrojtësit me autorizim ne lende Av.Korab Bokshi, me dt.08.03.2021; Deklarata e dëshmitarit: A. Z. e dhënë ne Prokurori me dt.23.02.2021; Deklarata e dëshmitarit: D. C. e dhënë ne Prokurori me dt.23.02.2021; Raporti i oficerit T. S. #10652, dt.08.02.2021; Raporti i oficerit A. B. PK 4748, dt.08.02.2021; Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt.08.02.2021; Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt.08.02.2021; Raporti i ekspertimit AKF/2021-0383/2021-367, dt.02.03.2021; Foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni në fjalën e sajë përfundimtare ka deklaruar se me dëgjimin e dëshmitarëve A. Z. dhe D. C., të cilët sot gjatë shqyrtimit gjyqësor treguan se si të njëjtit kanë blerë substancë narkotike nga këtu i akuzuari, e më pas edhe nga administrimi i provave materiale e po ashtu edhe nga pranimi i fajësisë i bërë nga ana e të akuzuarit, për veprën penale për të cilën akuzohet, konsiderojmë se në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, e ku gjykatës i propozon që të njëjtin ta shpall fajtorë ta dënoji në bazë të ligjit si dhe të e obligoi në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me vendimin mbi dënim si rrethana renduese të merr rrezikshmërinë e veprës, moshën e personave të atakuar me substancë

narkotike, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata të merr pranimin e fajësisë së bërë edhe në këtë fazë të procedurës.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. R. av. Ylli Bokshi, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në këtë çështje i mbrojturi im ka pranuar fajësinë ashtu që e lusim gjykatën që me pranimin e fajësisë të ketë parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese të parapara me nenin 70 par.3 të KPRK-së, ashtu që të ketë parasysh karakteristikat e këtu të akuzuarit, faktin që i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën e re të akuzuarit, bashkëpunimin e të akuzuarit me organet e drejtësisë, keqardhjen e shfaqur, dhe sjelljen e të njëjtit pas rastit të ndodhur. Andaj i propozoi gjykatës dhe i lutem që ndaj të akuzuarit K. R., gjykata të shkon në zbutjen të jashtëzakonshme të dënimit, të njëjtit mundësisht ti shqiptoi një dënim me kusht pasi që edhe me atë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, përkatësisht që kryesit ti parandalohet kryerja e veprës penale në të ardhmen.

I akuzuari K. R., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, ka shprehur keqardhje për rastin që i ka ndodhur dhe kërkon falje për veprimet që i ka ndërmarrë, ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

2. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana lehtësuese dhe disa rrethana posaçërisht lehtësuese. Si rrethanë rënduese ka marr për bazë shkallën e përgjegjësisë penale dhe shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, duke pasur parasysh se pasojat e veprës penale prekin drejtpërsëdrejti jetën dhe shëndetin e njerëzve, posaçërisht të rinisë, Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i moshës së re, nuk ka të kaluar kriminale, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor për veprën penale për të cilën ngarkohet. Prandaj duke i marr për bazë të lartpërmendurat gjykata ka zbutur dënimin nga neni 71 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së lidhur me nenin 49 par.2 të KPRK-së ku është përcaktuar se mund të shqiptohet dënimi i kushtëzuar edhe për veprat penale ku me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në 10 vjet, nëse zbatohen dispozita e zbutjes së dënimit, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar si dhe dënimin me gjobë dhe se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së. Sipas bindjes së gjykatës dënimet e tilla të shqiptuara janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

3. Vendimi mbi konfiskimin e narkotikut

Gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin plotësues duke i konfiskuar substancë narkotike në mbështetje të nenit 267 par.5 të KPRK-së, lidhur me nenin 282 par.1 të KPP-së, ku përcaktohet “pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet

automatikisht konfiskimit, pa marr parasysh gjetjet e gjykatës”, andaj ka konfiskuar substancën narkotike, e cila substancë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkartohej.

4. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që i akuzuari t’i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti për Krime të Rënda -
PKR.nr.50/21, me datë 18.11.2021

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.